

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po tallen me ne"/ Debate në Dhomën e Avokatisë, vendoset bojkot edhe për masat e sigurisë në GJKK O
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/23/po-tallen-me-ne-debate-ne-dhomen-e-avokatise-vendoset-bojkot-edhe-per-masat-e-sigurise-ne-gjkk/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:05:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	23 shtator 2026, 16:47:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 23 shtator 2026, 16:46:00 UTC → 23 shtator 2026, 16:48:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b9d8a99a391e1820f2cac687cf75b6f48eb49fa2e384f8efd2f4cfe79e6289ed
TEKSTI	491eeeca1f999519ee17ca69499e2964d3ce4e3c664d67282b89826e68e9f787
PAMJA	e77f91257cc26e054da88a34cca52d085caa4450f0822274b3a5930044c24b5c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1b66f37d73e6a48adef1e83ea3a81e6658347341e16331b8a9f6000a0a5bdfbb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1b66f37d73e6a48adef1e83ea3a81e6658347341e16331b8a9f6000a0a5bdfbb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

"Po tallen me ne"/ Debate në Dhomën e Avokatisë, vendoset bojkot edhe për masat e sigurisë në GJKKO

23/09/2026 18:47



Avokatët kanë vendosur të përshkallëzojnë bojkotin ndaj Gjykatës së Posaçme, duke e shtrirë tashmë edhe te seancat për masat e sigurisë.

Vendimi u mor këtë të mërkurë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë, pas përplasjes së krijuar me GJKKO-në për rregulloren e kundërshtuar nga avokatët dhe gjobat e vendosura ndaj mbrojtësve që nuk janë paraqitur në seanca në zbatim të bojkotit.

Dhoma e Avokatisë ka vendosur gjithashtu të marrë përsipër financiarisht gjobat e vendosura ndaj avokatëve, nëse ato mbeten në fuqi. Kreu i Dhomës, Maks Haxhiaj, bëri të ditur se gjobat do të kundërshtohen në të gjitha instancat gjyqësore.

Sipas tij, vendimi i mëparshëm për bojkotin është respektuar nga avokatët, ndërsa GJKKO ishte vënë paraprakisht në dijeni për të. Haxhiaj tha se, pavarësisht kësaj, disa gjyqtarë kanë vendosur gjoba ndaj avokatëve që nuk janë paraqitur në seanca.

Haxhiaj argumentoi se vendimet e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës janë të detyrueshme për anëtarët e saj dhe kundërshtoi që rregullorja e GJKKO-së të prevalojë mbi ligjin për profesionin e avokatit. "Edhe nga pikëpamja e hierarkisë është një rregullore që është poshtë ligjit, por dhe nuk është rregullore për ne. I vetmi ligj që ne i përullemi me korrektësi dhe zbatojmë është ligji për profesionin e avokatit", u shpreh Haxhiaj.

Kreu i Dhomës kritikoi gjithashtu mungesën e një reagimi nga drejtuesit e GJKKO-së ndaj kërkesave të avokatëve. Sipas tij, Dhoma kishte dërguar një letër me synimin për të zgjidhur situatën përmes dialogut, por nuk mori një përgjigje zyrtare nga drejtuesit e gjykatës.

Haxhiaj tha se përgjigjja e marrë më pas ishte firmosur nga kancelari i GJKKO-së dhe, sipas tij, nuk plotësonte kushtet formale të një komunikimi zyrtar mes titullarëve. Në përmbytje, shtoi ai, gjykata mbrojtë rregulloren që kundërshtohet nga avokatët.

Sipas Haxhiajt, nuk janë marrë në konsideratë as argumentet ligjore të paraqitura nga Dhoma, të cilat, sipas tij, mbështeten në Kushtetutë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, Konventën e Këshillit të Europës për mbrojtjen e profesionit të avokatit dhe Kodin e Procedurës Penale.

Megjithatë, Haxhiaj theksoi se Dhoma mbetet e gatshme për dialog dhe se qëllimi i bojkotit nuk është vendosja e gjykatave në kolaps.

"Ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi gjithmonë një palë bashkëpunuese", tha ai.

Kreu i Dhomës iu referua edhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, për të cilën tha se ka mbajtur një qëndrim mbështetës ndaj shqetësimeve të avokatëve dhe kritik ndaj

I Kryesore



"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlera Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

18:25

"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlera Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit

15:11

Një vit krim në seri në Sarandë/ Ministri i Brendshëm kërkoi shkrirjen e zinxhirit komandues, Feliks Hoda largohet nga drejtimi i komisariatit, ja kush e zëvendëson

16:21

El Niño i fuqishëm mund të shkaktojë 451 mijë vdekje nga nxehtësia në gjashtë muaj, cilat vende janë më të rrezikuara

16:21

I akuzuar për përdhunim tre vite më parë, ylli i PSG-së del përpara gjykatës

17:16

I Më të lexuarat

Kryeministri Rama komandon drejtuesin e ri të SHISH pas shkarkimit të Vlera Hysenit

"Pinte kafe çdo javë me ish-kreun e SPAK te zyra e tij"/ Urdhër-arresti ndaj Vlera Hysenit, gazetari Qyno në 'Top Story': Dumani hetoi edhe Fatos Klosin, por ai mori pafajësinë

"Bela me Taon janë shokë, do bëhët kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlera Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK

"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlera Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit

"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlera Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirri me u taku"/ Mesazhet e Vlera Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici

36-vjeçari shqiptar u vra në Itali teksa po vidhte, flet bashkëshortja: Djali im nuk ka më baba dhe unë jam e shkatërruar

Dokumenti/ Emri i Vlera Hysenit në dekreten francez për Urdhrin Kombëtar të Meritës, ish kreu i SHISH mes të huaive të propozuar për

rregullores së kundërshtuar.

Kritika pati edhe ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor. Haxhij tha se Dhoma i kishte kërkuar KLGJ-së një takim për të diskutuar problematikat e avokatëve në proceset gjyqësore, por nuk kishte marrë një përgjigje serioze. Sipas tij, çështja është diskutuar në KLGJ, por institucioni nuk ka mbajtur një qëndrim për rregulloren.

Gjatë mbledhjes pati debat për shkallën e përshkallëzimit të bojkotit. Një pjesë e avokatëve kërkuar që masat e sigurisë të përfshiheshin menjëherë, ndërsa të tjerë propozuan fillimisht një bojkot të përgjithshëm deri në dy javë.

Avokatja Edlira Kola, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, kërkoi kalimin të një masë më të fortë, duke argumentuar se bojkoti i deritanishëm ishte injoruar nga GJKKO.

"Mendoj se edhe ne duhet të marrim tani masa drastike, siç është ajo që të bojkotojmë seancat e masave të sigurimit. Besoj se ky mjet do të ishte efikas dhe do të kishim një reagim institucional nga kjo gjykatë", tha Kola.

Edhe një anëtare e Dhomës së Avokatisë së Vlorës, e cila tha se në mbledhjen e mëparshme nuk kishte qenë dakord me bojkotin në formën e propozuar, deklaroi se kishte ndryshuar qëndrim pas zhvillimeve të fundit.

"Po tallen me ne. Nuk po na marrin në konsideratë", tha ajo, duke mbështetur përfshirjen e masave të sigurisë në bojkot.

Një tjetër avokat kërkoi që ky hap të mos merrej menjëherë. Ai propozoi një bojkot të përgjithshëm deri në dy javë dhe vetëm nëse nuk do të kishte reagim, të kalohej te masat e sigurisë.

"Nuk duhet të shkojmë te masat e sigurimit. Është një vendim ekstrem, që mund të ketë pasoja shumë të mëdha. Për të shkuar aty duhet të përdorim bojkotin e përgjithshëm në një afat të caktuar, jo më shumë se dy javë", tha ai.

I njëjti avokat deklaroi se kishte marrë tashmë katër gjopa nga GJKKO e Shkallës së Parë dhe kërkoi që mbrojtja ndaj tyre të jetë kolektive dhe jo individuale, pasi gjobot lidhen me zbatimin e një vendimi të përbashkët të Dhomës.

"Unë sot kam gjobën e katërt që marr në GJKKO-në e Shkallës së Parë. Përpara një veprimi kolegjial, që është vendimi i Këshillit Kombëtar të Avokatisë për bojkotin, mbrojtja duhet të jetë kolektive", deklaroi ai.

Sipas tij, "avokacia si institucion nuk është spektatore e drejtësisë, por është faktor dhe aktor i drejtësisë".

Një tjetër propozim i hedhur gjatë diskutimeve ishte tërheqja nga GJKKO e listës së avokatëve që caktohen kryesisht për mbrojtjen e të pandehurve.

Avokati që paraqiti propozimin tha se kjo nuk duhet të konsiderohet "hakmarrje", por pjesë e reagimit të avokatisë ndaj situatës së krijuar.

Haxhij u ndal edhe te qëndrimi i dy avokatëve anëtarë të KLGJ-së. Sipas tij, avokati Tabaku ka mbështetur qëndrimin e Dhomës dhe ka kundërshtuar situatën e krijuar, ndërsa për avokatin tjetër tha se ka mbajtur një qëndrim indiferent.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli vendosi përshkallëzimin e bojkotit, duke përfshirë tashmë edhe seancat për masat e sigurisë.

Top Channel

gradën "Klorës"

"SPAK u nxitua me arrestin", eksperti i sigurisë, Xhavit Shala: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH, ndoshta me dorëheqje

A është gjetur Bleona Mata pas 16 vitesh? Përplasje LIVE mes nënës dhe avokatit në "Ftesë në 5": Do të të ndjek penalisht

I Aktualitet »



"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirr me u taku"/ Mesazhet e Vlorë Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe



Konsiderohej kumbar i grupeve shqiptare të narkotrafikut/ Kush është Shpëtim Aliu që u arrestua në Rusi, i njohur me nofken "Salvatore"



Drejtohte grupin që shpërndante kokainë nga Amerika Latine në Europë, arrestohet në Rusi 51-vjeçari Shpëtim Aliu

23/09 20:32

23/09 20:50



Tubimi në ditën e 116-të, protestuesit thirrje poshtë Kryeministrit: Nesër para Kuvendit, bashkohuni me ne!

23/09 19:00



Zjarr pranë liqenit të Viroit, digjet një sipërfaqe me bar dhe shkurre

23/09 18:57



16 vite nga zhdukja misterioze e Bleona Matës, SPAK reagon për "Ftesë në 5": Nuk kemi dosje të...

23/09 18:22

I Kryesore »



"Kur i jepni Rusisë para, i jepni më shumë kohë luftës"/ Zelensky bën thirrje nga OKB: Risni presionin ndaj Moskës

23/09 21:01



"Tao kryetar Kuvendi, Skenderi më thirr me u taku"/ Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici

23/09 20:50



Konsiderohej kumbar i grupeve shqiptare të narkotrafikut/ Kush është Shpëtim Aliu që u arrestua në Rusi, i njohur me nofkën "Salvatore"

23/09 20:48



Drejtonte grupin që shpërndante kokainë nga Amerika Latine në Europë, arrestohet në Rusi 51-vjeçari Shpëtim Aliu

23/09 20:32



"Do të largohem kur të mos më duan më"/ Ronaldo nuk ka ndërmend të tërhiqet: Kam dy objektiva, 1000 golat dhe...

23/09 19:17



Tubimi në ditën e 116-të, protestuesit thirrje poshtë Kryeministrit: Nesër para Kuvendit, bashkohuni me ne!

23/09 19:00

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Thesaret nën ujë ende të pazbuluara, ekspertët: Të rikthehen ekspeditat




Top Channel/ Mbledhja e kryesisë së PD, Berisha i mbledh në seli për qëndrimin që do mbajë opozita



Top Channel/ Frenon çmimi i banesave, duhen më shumë muaj për të shitur një apartament



Top Channel/ "Gati të flasim me Trump", Pezeshkian deklaroi në OKB se nuk janë terroristë



Top Channel/ Kushtetuesja konfirmon qeverinë! Kosovë, afat deri më 6 tetor për presidentit



Top Channel/ Përkallëzohet bojkoti i avokatëve, kundërshtojnë rregulloren e GJKKO

Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			
© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.					

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.